



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIMAL  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM  
NR 47 DATË 09.07.2021

**MBI MIRATIMIN PËR “Shprehjen e dakortësisë për binjakëzimin për shkëmbim eksperiencash bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjelltë midis Bashkisë Dimal me Comune di Campobasso Rajoni Molise Itali**

Këshilli i Bashkisë Dimal, në mbledhjen e tij të datës 09/07/2021, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur dhe realtuar nga Drejtoria Juridike, mbështetur në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 8 pika 2, 9 pika 1.1.b, 34,35,36,37,40,41,54 pika dh, Neni 55 neni 64 pika c, Ligji nr.68/2017 “Për Financat e vetëqeverisjes Vendore”, neni 45, V.K.B-së Nr.81, dt.24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Dimal për vitin 2021”, të ndryshuar, si dhe Ftesës së ardhur nga **Comune di Campobasso Rajoni Molise Itali**, Ligj Nr 34/2021 datë 16.03.2021 “Për Ndryshimin e Emërtimit të Njësisë së Qeverisjes Vendore nga “Bashkia Ura Vajguore” në “Bashkia “Dimal”, Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Numri 55 e Enjte, 8 Prill 2021

VENDOSI

**ME 14 VOTA PRO NGA 14 KËSHILLTARË PREZENTË**

1. Të miratojë: “Shprehjen e dakortësisë për binjakëzimin **“për shkëmbim eksperiencash bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjelltë midis Bashkisë Dimal me Comune di Campobasso Rajoni Molise Itali.**
2. Të shprehi dakortësinë për miratimin dhe mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit 3 ditor, të anëtarëve të Këshillit Bashkiak, në Itali, në kuadër të Programit të Shkëmbimit të Eksperiencës.
3. Ky fond do të akordohet nga fondi i planifikuar në Buxhet, nga struktura e aparatit të Bashkisë Dimal.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës së Bashkisë Dimal.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Kryetar i Këshillit Bashkiak  
Hysen Hoxha



